



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 69/2016

Prishtinë, më 27.9.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Mungoi: Glauk Konjufca, anëtar.

Pjesëmarrës i ftuar: Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Agron Maxhuni, Rexhep Bllaca, Elvis Feka - MTI, Kenan Gashi – AVONEI, Fjolla Uka – KDI, Dardan Abazi – INDEP, Etleva Malushaj – LVV.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Shkelzen Behrami - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.9.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-117 për Akreditim;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, e njoftoj Komisionin se në vend të deputetit Pal Lekaj nga GP AAK, tash është deputeti Rustem Berisha, të cilit i dëshiroj mirëseardhje në Komision. Pastaj propozoi futjen e një pike të re në rendin e ditës, si pikë e katërt: Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave, propozuar nga Qeveria.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga kryetari Mustafa.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20. 09. 2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 20.09.2016 , u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-117 për Akreditim

Kryetari- Tha se ky është një Projektligj i rëndësishëm që bënë rregullimin e standardeve të akreditimit. Lidhur me këtë e kemi të ftuar z. Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë, për ta arsyetuar projektligjin për akreditim, pastaj fjalën ia dha z. Kastrati për ta paraqitur ekspozenë e projektligjit.

Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë, tha se si bartëse e këtij projekti legjislativ shkurtimisht e paraqiti arsyen, qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për Akreditim. Propozimi i Projektligjit për Akreditim ndërlidhet me objektivat e Qeverisë respektivisht të MTI-së. Ai tha se Projektligji i Akreditimit përcakton parimet e akreditimit dhe rregullat për akreditimin e trupave të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit në Kosovë dhe fuqizon Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës. Arsyeja për hartimin e Projektligjit për Akreditim është përmirësimi dhe plotësimi i procedurave të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe të gjithë sistemit të akreditimit në Kosovë, i cili do të harmonizohet me praktikën e BE-së. Po ashtu, arsye tjetër është zgjerimi i aktiviteteve në fusha të reja të akreditimit bazuar në nevojat e palëve të interesit, duke përfshirë edhe akreditimin e laboratorëve medicinal, ngritjen e nivelit të kompetencës së të gjithë pjesëmarrësve në procesin e akreditimit, si të stafit permanent të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, po ashtu edhe të ekspertëve të jashtëm, përmirësimin e bashkëpunimit me palët e interesit, me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të të gjitha palëve të interesit. Arsyeja tjetër e ndryshimit të këtij ligji është MSA-ja, ku në nenin 20, 80 dhe 75 të MSA-së përcaktohet obligimi i Republikës së Kosovës që të marrë të gjitha masat e nevojshme për siguruar gradualisht përputhshmërinë me rregulloret teknike të Komunitetit dhe procedurave evropiane të vlerësimit të standardizimit dhe akreditimit. Ai theksoi se Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar Deklarata Financiare nga Ministria e Financave se nuk ka implikime shtesë buxhetore dhe Opinioni i Pajtueshmërisë me Legjislacionin e BE-së nga MIE se projektligji i lartpërmendur është i harmonizuar me Acquis-in e BE-së.

Kryetari- Tha se ky Projektligj e ka avancuar rritjen e standardeve dhe cilësisë në rregullimin e fushës së akreditimit. Projektligji është mjaft përfshirës dhe politika e siguruar në zbatim të standardeve, po ashtu projektligji për akreditim është në harmoni me MSA-në, që do të thotë se i gjithë sistemi i akreditimit në Kosovë do të harmonizohet me praktikën e BE-së. Mirëpo, paraqiti shqetësimin e tij lidhur me nenet 14 dhe 15 që kanë të bëjnë me emërimin e Këshillit Profesional dhe Këshillit të Akreditimit.

Besim Beqaj- Tha se ka shumë ligje që duhet të harmonizohen, lidhur në raport MSA- në, por Projektligji për Akreditim, konsideroi që ky duhet të ketë harmonizim me Doganën e Kosovës por për këtë do të kontribuojë, gjatë shqyrtimit në grupin e punës. Ai pastaj ngriti një çështje për markat tregtare që shumë biznese, po kanë problem në treg më monopolin e krijuar për markat tregtare. Pyeti se sa lëndë ka nga bizneset për regjistrim për markat tregtare dhe a keni kapacitete si ministri për regjistrimin e tyre, sepse ka shumë lëndë dhe kemi pranuar ankesa nga palët?

Kryetari lidhur me këtë çështje, pra markat tregtare, kërkoi që MTI-ja të përgatisë një informatë më shkrim për Komisionin.

Blerim Grainca- Tha se të tillë e përkrahu projektligjin për akreditim, por gjatë shqyrtimit në grupin e punës duhet të sqarohen disa fusha që e kanë të bëjnë me komunitetin e bizneseve. Mirëpo tha se duhet të sqarojmë nenin 7 të Projektligjit në grupin e punës sepse ka paqartësi.

Raif Qela- Tha se pasi që arsyeshmëria e ndryshimit të këtij ligji është MSA-ja, ky Projektligj e ka opinionin e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, atëherë edhe grupi i punës gjatë shqyrtimit nuk do të ketë shumë punë në nxjerrjen e amendamenteve. Neni 17 duhet të korrigjohet dhe harmonizohet në gjuhën shqipe.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet në parim Projektligjit nr. 05/L-117 për Akreditim.

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligji nr. 05/L-117 për Akreditim.

Komisioni vendosi që grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Enver Hoti, kryesues, Besim Beqaj dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë.

4. Shqyrtimi i Listës së kandidatëve për anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave, propozuar nga Qeveria

Kryetari- Tha që lidhur me këtë propozim të Qeverisë për anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave, sa i përket aspektit procedural dhe ligjor, shërbimi profesional i Kuvendit e ka shqyrtuar dhe ka dhënë një informatë që i plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore

për t'u proceduar për Kuvend. Ai theksoi se kriteret ligjore për përmbushjen e kushteve formale për kandidatët për anëtarë të ARH-së, janë të përcaktuara me nenin 38, pika 6, paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës dhe përveç se duhet kandidati të ketë diplomë universitare, në fushën e drejtësisë, ekonomisë, inxhinierisë ose të specializuara në sektorin e transportit; kandidatët duhet të kenë së paku tri vite përvojë pune adekuate në sektorin e transportit. Propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, bazuar në obligimet e përcaktuar me nenin 38 të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, i ka dërguar Kuvendit të Kosovës, propozimin me vendim me katër kandidatët për anëtarë të ARH-së, me këtë përbërje: Arsim Berisha, kryesues, Shkumbin Hyseni, Ilmi Ahmeti, dhe Gëzim Qerimi, anëtarë.

Besim Beqaj tha se ky Bord është mjaft i rëndësishëm i cili duhet të jetë jashtëzakonisht i koncentruar në rrjetin hekurudhorë. Mirëpo paraqiti vërejtje të kandidati Arsim Berisha, sa i përket kualifikimit tha e ka një diplomë të Universitetit Kristal nga Shqipëria, për të cilin universitet kemi shumë dyshime dhe kemi shumë certifikata në gjuhën italiane që i ka paraqit si master specializues. Ne e dimë se nuk ka seminar që jep titullin e masterit, duhet studim për master. Po ashtu, gjuha italiane nuk është gjuhë zyrtare. Prandaj nuk duhet t'i marrim aq për bazë pasi që nuk i kuptojmë sepse me rregullore thuhet se dokumentet duhet të jenë në gjuhë zyrtare.

Enver Hoti- Tha se edhe pse u pajtuam të fusim në rend ditë si pikë shtese, neve, si deputetë, na ka ardhur materiali sot dhe është dashur ta kemi më herët, edhe ne të hulumtojmë, pasi që për pak kohë që ju referuam këtij materiali shihet se kandidatët nuk janë kompetentë për këtë fushë kaq të rëndësishme dhe vijnë nga profesione krejtësisht të ndryshme, nuk paraqet seriozitet ky vendim që e ka sjellë Qeveria. Pastaj po dalin probleme në funksionimin dhe në ushtrimin e detyrave të cilët këta njerëz emërohen nëpër vendet e caktuara, e që janë shumë të rëndësishëm për drejtimin e këtyre autoriteteve. Këtu kemi kandidat me bacholer nga shkencat politike, gjë që nuk garanton ndonjë sukses që mund ta ushtrojnë në aspektin profesional për të cilin do të ngarkohet.

Kryetari- Tha se kemi një me biznes menaxhment, dy inxhinierë dhe një me shkenca politike. Por kanë përvojë në sektor. Ky është një sektor që kërkon njohuri specifike të një rëndësi shumë të madhe për vendin. Ne kemi marrë propozimin i cili është trajtuar shumë gjatë, tani shohim nëse nuk ka vërejtje. Ne, si komision, mund ta dërgojmë në Kuvend, dhe të vendosin deputetët.

Enver Hoti- Pyeti kryetarin se a ka pasur njerëz më specialistë në aplikim dhe pse është vonuar kaq gjatë Qeveria për të na futur sot në një situatë që për një javë të përfundohet. Kërkoj që nga Qeveria të kërkohet lista e kandidatëve që kanë konkurruar, të shohim mos ka pasur ndonjë person më kompetent se këta të propozuar.

Kryetari: Ky propozim më ka ardhur para vetes, është në procedurë, kur këta aplikojnë, kur një panel i zgjedh dhe duhet t'i shohim kushtet dhe deputetët vendosin. Për arsye se kjo ka shkuar në procedurë ne vetëm e dërgojmë mendimin tonë më rekomandime.

Besim Beqaj- Tha se nuk e dimë se çka nënkupton se ka shkuar në procedurë, ajo njëherë duhet të shkojë përmes nesh pozitiv ose negativ dhe pastaj të kalojë në procedurë të Kuvendit, nëse hyn në rend dite. Unë për vete nuk e votoj pasi që nuk ka nevojë të votohet nëse ka hyrë në rend

dite. Nëse ne sot kërkojmë shpjegim dhe mund të presim për 3-4 ditë të grumbullohemi përsëri sepse unë nuk ndihem komod me këtë gjendje. Ne kemi një njeri që ka provojë në fushën e biznesit, dy të tjerë që janë më kompetentë. Nëse kjo është vetëm për formalitet është diçka tjetër.

Kryetari: Sa i përket shqetësimit të deputetit Hoti, tha se secili deputet mund të ketë qasje në çdo dokumentacion zyrtar dhe ju mund të kërkonit nga Qeveria dokumentacion shtesë ose të shkoni vetë në Qeveri dhe ta vërtetoni këtë që po e ngrehni si çështje. Por nëse jeni të pajtimit e shtojmë për mbledhjen e radhës.

Raif Qela- Tha se nga baza ligjore dhe procedurale është gjithçka në rregull, që të mos kemi kësi lloj dilema se a po dërgojmë në agjenci të pavarura përfaqësues që dinë ta kryen punën e vet a jo, lidhur me këtë duhet të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me agjencitë e pavarura me procedurë të shpejtë t'i plotësojmë dhe t'i ndryshojmë në frymën e asaj që t'i forcojmë kriteret e personave që zgjedhën në këto agjenci të pavarura. Sepse përndryshe po kemi dilema sidomos më ata që vijnë në pako që duhet apo nuk duhet të votohen të gjithë.

Fatmir Rexhepi- Tha se kemi diskutuar disa herë, duhet të nisemi nga situata që jemi tash, autoriteti që ne kemi është t'i rekomandojmë Kuvendit për ose kundër. Dhe të ndalemi në fushën që na takon, pasi jemi konsumuar në këtë temë, na konvenon nuk na konvenon, e drejta jonë është të rekomandojmë të japim raport shtesë, të mos e ndërlikojmë situatën dhe të jemi brenda kompetencave tona.

Besim Beqaj- Tha se është e rëndësishme të sqarohet, por nëse të gjithë e shiheni të arsyeshme ju hidheni në votim, pozitiv ose negativ ja dërgojmë Kuvendit. Nëse mendoni se ne nuk kemi se çfarë të vendosim atëherë duhet t'i ndryshojmë procedurat të mos kaloj nga ne kjo fare. Unë vetëm ngrita shqetësimin tim personal, por nëse doni ju hidheni lirisht. Unë do të jem i përmbytur në votën time pasi që nuk kam informacione të plota edhe pse me shumë qejf do t'i kisha votuar disa.

Fatmir Rexhepi- Tha se ne duhet të ngelim brenda kompetencave që kemi si Komision se duhet t'i rekomandojmë Kuvendit me dokumentet që na ka dhënë Qeveria, por vendimin tonë ta japim brenda kompetencave që ne kemi. Secili prej nesh mund të ketë rezervë të caktuara dhe mund të votojë apo të mos votojë.

Rrustem Berisha- Tha se ky Bord është i rëndësishëm dhe ne kemi marrë materialin shumë vonë për ta dhënë rekomandimin pro apo kundër. Pajtona me vendimin për ta shtyrë për disa ditë pasi që ne kemi kohë të informohemi më shumë që vota jonë të jetë e drejtë.

Kryetari propozoi që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

5. Të ndryshme

a) Projektligji për Trepçën

Fatmir Rexhepi- Tha se lidhur me Projektligjin për Trepçën, dua të di se a ka interesim dhe a ka takim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pasi kanë bërë përzgjedhjen e kompanisë për studimin në fizibilitet. Pyeti a ka ndonjë informatë shtesë se në cilën fazë jemi që të mos krijojmë probleme politike?

Raif Qela- Tha se studimi i fizibilitetit që organizohet nga AKP-ja edhe studimet e rasteve që janë bërë të iniciuara nga Kuvendi janë të mirëseardhura, por hapi i parë që ta çeli rrugën për Trepçën është Ligji. Se çfarë rruge do të marrë më vonë Trepça, varet prej studimit të fizibilitetit dhe prej rezultateve të tyre, mendoj se janë rrugë të ndara.

Kryetari- Tha se afati për ta përfunduar studimin e fizibilitetit është 4 muaj, por besoj se nuk do të përfundohet për 6 muaj. Ju njoftoj se është kontraktuar një kompani prestigjioze që siguron standarde të cilësisë. Unë pajtohem me atë që tha z. Qela që ligji e rregullon statusin, ndërsa studimi i fizibilitetit ka të bëjë më aspektet zhvillimore të tregut.

Besim Beqaj- Tha se pavarësisht se janë dy gjëra ta ndara nga njëra tjetra, fizibiliteti do t'i thotë Qeverisë se çfarë ligji do të duhet ta bëjë dhe t'i përshtatet. Duhet ta kuptojmë se ligji nuk është problem i Trepçës, dua ta them hapur ligji mund të bëhet për 1 ose 2 javë, dhe janë 2 opsione, ta marrim e ta bëjmë ndërmarrje publike dhe e dyta me ndarë atë pjesën që nuk është substanciale për Trepçën të merret me pjesën funksionale. Problemi është politik, Qeveria duhet t'i bëjë zgjedhje politike, duhet ta kuptojnë qytetarët se ligji nuk është problem. Duhet të zgjidhën problemet e tjera të funksionimit, pasi ligji bëhet shumë shpejt, por ligji duhet të reflektoj të prioritetet politike. Jemi duke kamufluar, ligji është në njërën anë, strategjia në tjetrën anë, fizibiliteti në një anë dhe nuk përputhen me njëra-tjetrën.

Kryetari- Tha se nuk ka kamuflim, janë disa vonesa për disa arsye dhe ajo vonesë krijon disa shqetësime dhe nuk ka asnjë rrezik që Trepça të shkojë në falimentim edhe pas këtij afati për 18 muaj, Dhoma e Posaçëm e Gjykatës Supreme nuk mund të iniciojë procedurat e falimentimit edhe për 18 muaj të tjerë. Situata në Trepçë çdo ditë është në humbje për proceset zhvillimore, besoj se ligji do të vijë dhe ligji krijon kushtet, infrastrukturën, organizmin, por çështjet e tregut financave ekonomisë do të bëhen më vonë. Mos ta politizojmë çdo gjë, interesat janë të përbashkëta edhe pozitë edhe opozitë, para se të vijë ligji këtu duhet ta ruaj unitetin.

Fatmir Rexhepi- Tha se i gjithë qëllimi im ishte ky se si ta harmonizojmë këtë. Ne duhet ta bëjmë këtë komplementare. Pjesa politike mbetet pjesa e fundit që i bashkëngjitet kësaj, ta bëjmë më të mirën, mos të bëjmë këtë ligj sa vetëm për ta pasur.

Kryetari: Në fillim të tetorit do ta ftoj më ministrin dhe do ta diskutojmë këtë çështje.

Komisioni u pajtua më konkluzionin e kryetarit Mustafa.

b) Mbikëqyrja e Ligjit për Miniera dhe Minerale

Sala Berisha Shala: Grupi i punës për miniera dhe minerale, ka filluar agjendën e vet dhe i ftoj deputetët që janë në këtë grup, t'i bashkohen punës, se jemi në kohën që jemi në terren, zbatimi i këtij ligji është i rëndësishëm. Ajo theksoi se kur është mbajtur dëgjimi publik në Kuvend, nuk ka qenë askush nga anëtarët e komisionit, përveç z. Raif Qela. Kjo tregon se në minierat dhe mineralet nuk i marrim seriozisht dhe nuk duhet tani të bëjmë diskutimin të pakufi për Trepçën, sepse ai është vetëm një burim i Kosovës, Kosova ka shumë pasuri të tjera, ejani t'i hulumtojmë.

Blerim Granica- Kërkoi që çështja e “Trepçës” të hyjë si pikë e veçantë në rendin e ditës, e jo të bisedohet në shumë pika të ndryshme dhe të komplikohet.

Rrustem Berisha- Tha se është një temë tepër e rëndësishme me hy si pikë e veçantë, jo si në të ndryshme, pasi që po bëhet jo serioze. Prandaj duhet ta kemi një strategji dalëse, pasi nuk duhet të jetë kauzë politike, por çështje kombëtare. Kërkoj që të jetë pjesë e grupit të punës për monitorimin e Ligjit për miniera dhe minerale.

Komisioni vendosi që grupit të punës t'i shtohet edhe anëtari i ri, deputeti Rrustem Berisha.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa